

Tirane me, 28.10.2020

Nr. 52 Prot.

Drejtuar: Z. Petrit AHMETI**ENTI RREGULLATOR I ENERGJISE****Adresa: Bulevardi "Bajram Curri", Rr. Viktor Eftimiu, Nr. 1023, Tirane.**

Subjekti: Kerkese per Derrogim bazuar ne vendimin Nr.85, Datë 12.05.2020, te Bordit te ERE, si dhe parashtimet perkatese per sa kerkuar ne kete vendim.

I Nderuar Z. Ahmeti,

Shoqeria HEC Arsti sh.p.k, me numer NIUS L61601028F, zoteruese e HEC ARSTI me vendimin e Bordit te ERE nr. 218, date 20.12.2019 eshte paisur me Licensen per Prodhimin e Energjise elektrike Seria P19, dhe numer License 456.

Ne zbatim te kontrates se neshkruar me autoritetin shteteror shoqeria ka vijuar punen per realizimin e HEC ARSTI me fuqi totale te instaluar 4 MW. HEC ARSTI ndodhet ne perroin e Arstit, Fierze, Bashkia e Fushe Arrezit. Shoqeria konform percaktimeve ligjore ka aplikuar prene OST sh.a. per lidhjen me rrjetin e transmetimit 110 kV. Lidhja me rrjetin e transmetimit do te behet nepermjet nje nenstacioni 110/6,3 kV, prane HEC ARSTI, me fuqi Transformatori 1 x 8.5 MVA, dhe nje linje elektrike ajrore 110 kV me dy qarqe rreth 800 meter te gjate dhe me percjelles ACSR-240 mm², duke care linjen 110 kV Fierze – Dardhe midis shtyllave Nr. 85 dhe Nr. 86.

OST sh.a. me shkresen Nr. 6182/1 prot., date 22.10.2020, (bashkelidhur shkresa e OST sh.a.) nder te tjera parashtron si me poshte vijon:

...."Per plotesimin e trakteve me te gjithë elementet te shtrire ne dy faza implementimi dhe duke marre ne konsiderate investimin qe po kryeni, theksojme se referuar bazes ligjore qe rregullon procesin e lidhjeve me rrjetin Ju duhet te miratoni derrogimin nga ky rregull prane Entit Rregullator te Energjise. Ne kushtet e miratimit te ketij derrogimi per plotesimin e trakteve te linjave 110 kV me te gjithë elementet e nevojshem primar dhe sekondar nga ERE, OST shprehet e gatshme qe te reflekoje te dy fazat e zhvillimit te projektit sipas planit kohor te percaktuar dhe jo me vone se dy vjet nga miratimi ne ERE"....

Ne keto kushte Bordi i ERE me vendimin nr.85, datë 12.05.2020 ka miratimin e kriterëve për të vendosur derogime për modulet gjeneruese të energjisë elektrike. Kjo rregullore ben te mundur dorzimin e kerkeses tone per te kerkuar derrogimin e sygjerruar nga OST sh.a. me shkresen e siperpermendur.



Bordi i ERE me vendim nr. 85, datë 31.05.2019 mbi miratimin e “niveleve kufi/pragjet për klasifikimin e gjeneruesve të rinj me sistemin, në tipin a, b, c dhe d, sipas vendimit të ERE-s nr. 129, datë 04.06.2018, “mbi miratimin e kodit të rrjetit mbi kërkesat për lidhjen me rrjetin e gjeneruesve”. Ky vendim ben klasifikimin e gjeneruesve sipas tabelës së mëposhtme.

Tipi A	Niveli i tensionit në pikën e lidhjes <110kV dhe Kapaciteti i moduleve $800W \leq P_{Max}^{Kapaciteti} < 1MW$
Tipi B	Niveli i tensionit në pikën e lidhjes <110kV dhe Kapaciteti i moduleve $1MW \leq P_{Max}^{Kapaciteti} < 10MW$
Tipi C	Niveli i tensionit në pikën e lidhjes <110kV dhe Kapaciteti i moduleve $10MW \leq P_{Max}^{Kapaciteti} < 30MW$
Tipi D	Niveli i tensionit në pikën e lidhjes $\geq 110kV$ ose Kapaciteti i moduleve $P_{Max}^{Kapaciteti} \geq 30MW$

Duke marrë në konsideratë tabelën e mësipërme HEC ARSTI, me fuqi të instaluar 4 MW parashikon të rrjetin e transmetimit 110 kV dhe për rrjedhojë klasifikohet si Modul Gjenerues i tipit D. Kriteret për të vendosur derogime për modulet gjeneruese të energjisë elektrike të miratuara me vendimin nr.85, datë 12.05.2020, të Bordit të ERE legjitimojnë që edhe HEC e Tip D kanë të drejtë të kërkojnë derogim.

Pershkrim i Derrogimit të Kerkuar

Kompania HEC ARSTI sh.p.k, zoteron kontratën e koncesionit të formës BOT (bashkelidhur kontrata e lidhur me ministrinë e Energjisë dhe Industrisë) për ndërtimin, operimin dhe transferimin e HEC ARSTI. Shoqëria është paisur me leje ndërtimi nr. 60/4 datë 24.04.2019 dhe në zbatim të detyrimeve ligjore ka nderuar veprën energjitike. Prej 1 (një) viti shoqëria HEC ARSTI ka perfunduar të gjitha punimet e ndërtimit dhe ka njoftuar në MEI për perfundimin e punimeve. Aktualisht nga OST sh.a. është marrë miratimi paraprak për lidhje me rrjetin 110 kV të transmetimit. OST sh.a. me shkresën Nr. 6182/1 prot., datë 22.10.2020, ka sygjerruar kerkimin e derrogimit pranë ERE lidhur me percaktimet e kodit të transmetimit.

Kodi i Transmetimit është miratuar me Vendimin e Bordit të ERE, Nr. 186 Datë 10.11.2017, ndryshuar me vendimin 129 datë 04.06.2018. Në të njëjtën kohë Bordi i ERE me vendimin nr.85, datë 12.05.2020 ka miratuar kriteret për të vendosur derogime për modulet gjeneruese të energjisë elektrike. Bordi i ERE me vendim nr. 85, datë 31.05.2019 mbi miratimin e “niveleve kufi/pragjet për klasifikimin e gjeneruesve të rinj me sistemin, në tipin a, b, c dhe d. Bordi i ERE me vendimin

nr. 129, datë 04.06.2018, ka miratuar Kodin e rrjetit mbi kërkesat për lidhjen me rrjetin e gjeneruesve.

Bazuar ne keto akte ligjore kerkojme derrogim te perkohshem per nje periudhe 24 mujore sipas edhe rekomandimit te OST sh.a. me shkresen Nr. 6182/1 prot., date 22.10.2020.

Ky derrogim vjen per faktin se parashimimi i realizimit te traktit 110 kV te linjes dhe trakti 110 kV te transformatorit ngrites qe parashikohet te instalohet ne Nenstacionin 110/63 kV prane HEC ARSTI mund te paiset me te gjithë elementet e nevojshem primare ne dy faza implementimi. Ne fazen e pare parashikohet qe trakti 110 kV te jete i pasitur me thike ndarese per nje peridhe 24 mujore dhe pas kesaj periudhe te paiset me te gjithë elementet e nevojshem thike dhe celes.

Realizimi i ketij projekti me dy faza sic permendur me siper vjen per faktin se ne fillim te realizimit te ketij projekti ka nenshruam marveshjen per pike midhje me Nr. 30990/3 Prot. date 05.01.2017 me Operatorin e Shperndarjes se energjise Elektrike OSHEE sh.a. (bashkelidhur marveshja perkatese). Ne kete mareveshje parashikohet lidhja e HEC ARSTI me rrjetin e shperndarjes nepermjet linjes 35 kV nga Hec-I ne nestacionin 10 kV Gropaj.

Shoqeria viojoi pune per realizimin e kesaj lidhje, por pergjat realizimit te projektit u konstatuan se rrjeti i shperndarjes 10 KV nuk mund te trasmetonte gjithë energjine elektrike qe mund te gjenerohet nga HEC ARSTI. Per kete arsye u kerkua prane OST sh.a. lidhja me rrjetin e trasmetimit. OST sh.a. nepremjet shkreses Nr. 6182/1 prot., date 22.10.2020 ka dhene miratimin ne parim per realizimin e lidhjes dhe ka propozuar aplikimin per derrogim ne ERE.

Ne keto kushte qe ka perfunduar ndertimi i HEC dhe pamundesohet venia ne operim i tij per shkaqe objektive pasi pamundesia e rrjetit 10 kV te shperndarjes ka bere ne te nevojshme ligjen ne rrjetin 110 kV kerkojme derrogim prane ERE per bazuar ne dispozitat e nenit 12 te kodit te trasmetimit por edhe rregullores miratuar me vendimin nr.85, datë 12.05.2020.

- Afati i kerkuar i derrogimit 24 muaj.
- Objekti i derrogimit: Realizimi i traktit 110 kV te linjes dhe trakti 110 kV te transformatorit ngrites qe parashikohet te instalohet ne Nenstacionin 110/63 kV prane HEC ARSTI ne dy faza implementimi. Ne fazen e pare parashikohet qe trakti 110 kV te jete i pasitur me thike ndarese per nje peridhe 24 mujore dhe pas kesaj periudhe te paiset me te gjithë elementet e nevojshem thike dhe celes.

Vleresime te analizes kosto perfitim

Hidrocentraci Arsti do te shfrytetoje ujrat e perroit te Arstit. Ky projekt do te kete nje hidrocentral i tipit me derivacion me keto parapetra:

Fuqia e instaluar (kW)	N = 3130 kW
Energjia Mesatare vjetore (kWh)	E = 12,447,510 kWh/vit

Periudha e koncesioit te forms BOT eshte parashikuar per 35 vjet qe fillon nga data e hyrjes ne fuqi te kontrates. Investimi i koncensionarit i parashikuar ne kontraten koncensionare eshte ne vleren 225,125,130 Leke pa TVSH.

Neni 16 i kontrate parashikon se Koncensionari duhet te paguaje per llogari te Autoritetit Kontrktor (Shtetit Shqiptar) nje tarife koncensionare te barabarte me 2 % te prodhimit vjetor te energjise elektrike.

Duke marre ne konsiderate prodhimin mesatar $E = 12,447,510$ kWh/vit, tarifa koncensionare parashikohet te jete 248,950.2 kWh/vit.

Tarifa e energjise elektrike qe do ti paguhet prodhuesve te energjise elektrike nga hidrocentralet sipas vendimeve respektive te Bordit te ERE per vitin 2020 eshte: Periudha 1.01.2020 – 12.06.2020 eshte 8,0532 Leke/kWh. Periudha 12.06.2020 – 31.12.2020 eshte 7,448 lek/kWh.

Duke marre ne konsiderate sa parashtruar me siper mosvenia ne pune e HEC Arsti do te shkaktonte nje humbje per shoqerine ne vit prej $12,447,510$ kWh/vit X 7,448 lek/kWh = 92,709,054.5 Lek/Vit.

Gjithashtu nuk do te paguhet tarifa koncensionare per llogari te Autoritetit Kontrktor (Shtetit Shqiptar) ne sasine 248,950.2 kWh/vit, dhe ne vlere duke marre ne konsiderate cmimin 7,448 lek/kWh te miratuar nga ERE prej 1,854,179.6 Leke/Vit.

Financimi i realizimit te ketij Hidrocentrali eshte mundesuar duke perdorur linjat e kreditimit dhe pamundesia per te gjeneruar te ardhura mva mungesa e operimit do te krijonte veshtiresi per Shoqerine kundrejt bankave kredituese por edhe ne realizime te pagesave per palet e treta te cilat mirmbajne kete veper.

Vec sa me siper vendi jone eshte nje vend neto importues i energjise elektrike dhe per rrjedhoje venia ne pune e burimeve gjeneruse si ne rastin konkret te HEC Arsti do te ndikonte pozitivisht per te rritur gjenerimin vendas te energjise elektrike dhe ulur importin e saj.

Venia ne pune e HEC Arsti do te rris prodhimin vendas te energjise sikurse parashtruar me siper ne nje nivel mesatar vjetor prej 12,447,510 kWh/vit.

Ne vijim parashtojme dokumentacionin shoqerues qe i bashkelidhet kesaj kerkese.

1. Shtojca 1 Format i kerkeses per derrogim nga pronaret e moduleve gjenerues te energjise elektrike.
2. Kontrate e koncesionit e formes BOT (Ndertim, Operim, Transferim) per ndertimin e Hidrocentral Arsti.
3. License per veprimtarine e prodhimit te energjise elektrike seria P19, numri 459.
4. Kontrate per mbikqyrjen e punimeve te HEC ARSTI.
5. Ekstrakt Historik i regjistrimit tregtar, te dhena te subjektit "Shoqeri me Pergjejsi te Kufizuar".
6. Shkresa nr. 43/2 Prot., date 17.01.2019, e Agjensise per Zhvillimin e Teritorit.

7. Shkrese nr.12162/1 Prot. date 15.10. 2018 e Ministrise Infrastruktures dhe energjise.
8. Kontrate siperparje per ndertimin e Nenstacionit 110/63 kV Hec Arsti si dhe ndertimi i linjes 110 kV me dy qarqe per lidhje me rrjetin elektroenergjitik.
9. Shkrese drejtuar OST sh.a. ne date 30/01/2019.
10. Deklarate mjedisore Nr. 5360/1 Prot. date 27.06.2017.
11. Leje per perdorimin e burimit Ujor, Nr. Prot 370, date 15.08.2018.
12. Leje ndertimi Nr. 60/4 date 24.04.2019.
13. Njoftim per perfundimin e punimeve per MEI, nr. 46 prot., date 14.04. 2020.
14. Police Sigurimi nga Rreziqet inxhinierike Nr. Serial 46471121.
15. Shkrese Nr. 243/43 Prot, date 01.08.2017, mbi miratimin e projektit te zbatimit te hidrocentralit ARSTI.
16. Miratim pike lidhje OSHEE sh.a. me nr. 30990/3 date 05.01. 2017.
17. Shkrese nr. 4619/1 prot, date 30.09.2019, e OST sh.a.
18. Shkrese nr. 3771 Prot., date 14.05.2020 e ministrise se Infrastruktures dhe Energjise.
19. Shkrese nr. 6182/1 prot. date 22.10.2020, Miratim ne parim i kerkeses per piken e lidhjes me rrjetin e transmetimit te HEC Arsti nga OST sh.a.
20. Gen plan i Objektivit HEC – Arsti ne shkellen 1 : 25 000.

Per gjithë sa parashtuar me siper vlersojme se Shoqeria HEC Arsti sh.p.k., ploteson te gjithë kriteret per te kerkuar derogimin e mesiperm ne menyre qe te realizohet lidhja e hidrocentralit me rrjetin e transmetimit.


Ne keto kushte lutemi te merrni ne konsiderate kerkesen tone.

Me respekt,

ADMINISTRATOR

HEC ARSTI SH.P.K

Lulezim PEPA



Formati i kërkesës për derogim nga pronarët e moduleve gjeneruese të energjisë elektrike

I- Të dhëna të përgjithshme për aplikantin

Emri	HEC-Asti Sh.p.K.		
Selia	TIRANE		
Adresa	Nj. Boshkriqes; Ri. Urani Pano, P.11, K2, Zyra 2.		
Adresa e emailit			
Nr.telefon			
Faks			
Aplikanti: Numri i Identifikimit në QKR Licensuar nga ERE me Vendim Nr. 218/19 datë Data e lidhjes së Marrëveshjes së Lidhjes	<input checked="" type="checkbox"/>	Zoteruesi i objektit gjenerues	<input type="checkbox"/>
			Palë e tretë (nëse moduli është i tipit A)
Të dhënat i përkasin: (shënojeni kur është e përshtatshme)	<input type="checkbox"/>	Zoteruesi i objektit gjenerues	<input type="checkbox"/>
			Palë e tretë (nëse moduli është i tipit A)

II- Person kontakti i aplikantit

Emri dhe mbiemri	Lulëzim Pepa		
Pozicioni	Administrator		
Adresa e emailit			
Numrat e telefonit			
Të dhënat i përkasin: (shënojeni kur është e përshtatshme)	<input checked="" type="checkbox"/>	Zoteruesi i objektit gjenerues	<input type="checkbox"/>
			Palë e tretë

III- Të dhënat bazë për objektin

Emri			
Tipi i modulit gjenerues (A, B, C, D, sinkron, josinkron)	Tipi D		
Lloji i burimit primar të energjisë			
Vendndodhja/pika e lidhjes	Përroi Astit, F. Avëz, Linjo 110 KV Fierë-Dardhë		
Kapaciteti instaluar [kW] ose (MW)	4 MW		
Tensionii lidhjes [kV]	110 KV		
Çertifikata e pajisjes lëshuar nga një certifikues i autorizuar (shënojeni sipas nevojës)	Po		Jo
Jetëgjatësia	N/A		
Koha e pritshme e vendosjes në punë	35 Vjet Koncesioni		
	Nëntor 2020		

Referenca në dispozitat për të cilat kërkohet kufizimi dhe shkaqet e detajuara	Plotësimi i trokitit 110KV me elementët primor dhe sekondor.	
Per sa kohe kërkohet derogimi (jave, muaj, vit)	Nga	deri (24 muaj) Nendor 2020 - Nendor 2022


IV- Lista e dokumentave

a) Dokumentat bazë

Prova	Të paraqitura (shënonimë poshtë kur është nevojshme)
Përshkrimi i moduleve gjeneruese për të cilat kërkohet derogim	<input checked="" type="radio"/> Jo
Përshkrim i detajuar për derogimin që kërkohet	<input checked="" type="radio"/> Jo
Arsyetim i detajuar i shkaqeve së bashku me dokumentat mbështetës dhe analizën kosto-përfitim	<input checked="" type="radio"/> Jo
Demonstrim që derogimi i kërkuar nuk ka efekte të kundërta tek tregëtia ndër- kufitare	<input checked="" type="radio"/> Jo

b) Dokumenta tjetra

Nr.	Emri i Dokumentit
1.	Analiza e koston ne bashkëpunim e operatorin e sistemit ku eshte lidhur gjeneruesi N/A
2.	OST Kerkon miratimin e Derrogimit nepermjet
3.	shkreses N° 6182/1 Prot, date 22/10/2020 mbi
4.	miratimin ne parim per pikën e lidhjes me rrjetin e
5.	transmetimit per HEC Arsti.

Vendi dhe data ku është plotësuar kërkesa	Vendi: Tiranë	Data: 28.10.2020
Emri dhe Mbiemri i Personit përgjegjës	Lulezim Pepa.	
Firma e personit përgjegjës dhe vula		





OPERATORI I SISTEMIT TË TRANSMETIMIT
DEPARTAMENTI I RRJETIT TË TRANSMETIMIT
DREJTORIA E PLANIFIKIM ZHVILLIMIT TË RRJETIT TË TRANSMETIMIT

Nr. 6182/prot.
↓

Tiranë, më 22.10.2020

Lënda: Miratim në parim i kërkesës për pikën e lidhjes me rrjetin transmetimit të HEC Arsti

Z. Lulëzim Pepa
ADMINISTRATOR
HEC ARSTI Sh.p.k.

Nj.Bashkiake Nr.9, Rr.Urani Pano, Pll. Nr.11, K.2, Zyra Nr.2, Tiranë

Në përgjigje të shkresës Tuaj me Nr.Prot.50, datë 15/10/2020, me anë të së cilës kërkonti miratimin në parim për lidhjen me rrjetin e transmetimit të energjisë elektrike të HEC Arsti, në përroin e Arstit, Fierzë, Bashkia F.Arrëz, me fuqi totale të instaluar prej 4 MW, dhe bazuar në shkresën Nr.3771 Prot., datë 14/05/2020, dëshirojmë t'ju bëjmë me dije si më poshtë:

OST sh.a. ka kryer vlerësimin e mundësisë së lidhjes së HEC-eve në pikën e propozuara të rrjetit të transmetimit dhe duke marrë në konsideratë pamundësinë e lidhjes në rrjetin e shpërndarjes sipas komunikimit me OSSH sh.a. Në kushtet aktuale OST miraton në parim lidhjen me rrjetin e transmetimit të HEC Arsti, me fuqi totale të instaluar prej 4 MW. Për sa më sipër vlerësojmë që:

Lidhja e Hidrocentralit Arsti, me fuqi të përgjithshme të instaluar prej 4 MW, referuar kërkesës Tuaj, me rrjetin 110 kV të transmetimit, do të bëhet nëpërmjet ndërtimit të një nënstacioni 110/6,3 kV pranë HEC Arsti, me fuqi transformatorike 1 x 8,5 MVA (sipas propozimit Tuaj) dhe një linje elektrike ajrore 110 kV me dy qarqe, rreth 800 m të gjatë dhe me përcjellës ACSR-240 mm² (bazuar në standartin e OST sh.a.), duke çarë linjen 110 kV Fierzë – Dardhë midis shtyllave Nr.85 dhe Nr.86.

Traktet 110 kV (Hyrje-Dalje) të linjës dhe trakti 110 kV i transformatorit ngritës që parashikohet të instalohet në N/Stacionin 110/6,3 kV pranë HEC Arsti duhet të jenë të pajisur me të gjithë elementët e nevojshëm primarë dhe sekondarë, në përputhje me Kodin e Rrjetit të Transmetimit dhe standartet e përdorura nga OST sh.a. Për plotësimin e trakteve të linjave me të gjitha elementët të shtrirë në dy faza implementimi (sikundër ju e propozoni) dhe duke marrë në konsideratë investimin që po kryeni, theksojmë se referuar bazës ligjore që rregullon procesin e lidhjeve me rrjetin Ju duhet të miratoni derogimin nga ky rregull pranë Entit Rregullator të Energjisë. Në kushtet e miratimit të këtij derogimi për plotësimin e trakteve të linjave 110 kV me të gjithë elementët e

nevojshëm primar dhe sekondar nga ERE, OST shprehet e gatshme që të reflektojë të dy fazat e zhvillimit të projektit sipas një plani kohor të paracaktuar dhe jo më vonë se dy vjet nga miratimi në ERE.

Projekti i plotë i zbatimit që përfshin linjën elektrike ajrore 110 kV dhe N/Stacionin ngritës 110/6,3 kV pranë HEC Arsti, duhet të miratohet nga OST sh.a. përpara fillimit të zbatimit të tij. Investitori duhet të zbatojë të gjitha kushtet teknike të projektimit dhe të zbatimit të paisjeve dhe instalimeve elektrike në këtë investim. OST sh.a. do të jetë mbikqyrëse në të gjitha fazat e projekt-zbatimit të këtij investimi për pjesën që i përket daljeve të linjës 110 kV dhe impjantit 110 kV, deri në kolaudimin përfundimtar të tij.

OST do të ketë akses të plotë për të bërë në të ardhmen zgjerimin e N/Stacionit të ri ngritës 110/6,3 kV pranë HEC Arsti me një dalje të re 110 kV, për nevoja të zhvillimit të sistemit të transmetimit. Për këtë arsye në sheshin e nënstacionit duhet të parashikohet hapësirë e lirë për zgjerimin e tij sipas një planimetrie të aprovuar nga OST.

Të dhënat teknike të paisjeve 110 kV që do të përdoren si dhe sistemi i kontrollit dhe mbrojtjes të transformatorit ngritës 110/6,3 kV, duhet të jenë në konformitet të plotë me publikimet më të fundit të standarteve IEC dhe EN. Specifikimet teknike të paisjeve 110 kV dhe atyre të kontrollit dhe mbrojtjes së elementeve të anës 110 kV të transformatorit duhet të plotësojnë parametrat teknike kryesore sipas Kodit të Rrjetit të Transmetimit dhe miratuar nga OST.

Pika e matjes së energjisë elektrike që HEC Arsti, me fuqi të përgjithshme të instaluar 4 MW, do të injektojnë në Rrjetin e Transmetimit, do të jetë në daljen 110 kV të transformatorit ngritës 110/6,3 kV me fuqi të instaluar 1x8,5 MVA, dhe duhet të plotësojë standartin e kërkuar nga Kodi i Rrjetit të Transmetimit/Kodi i Matjes.

Për qëllime të drejtimit të centralizuar të sistemit elektro-energjetik dhe veprimeve operative të nevojshme, transformimi 110/6,3 kV në N/Stacionin pranë HEC Arsti, përveç lidhjes direkte të telekomunikacionit me N/Stacionin 220/110/10 kV Fierzë, duhet të futet në sistemin SCADA të Qendrës Kombëtare Dispeçer. Të gjitha investimet që duhen për instalimin e paisjeve për këtë qëllim do të rakordohen me OST dhe duhet të përballohen nga investitori.

Periudha kohore e vlefshmerise e kësaj oferte të lidhjes është 18 muaj. Brenda kesaj periudhe, nëse shoqëria "HEC ARSTI" sh.p.k. do të shfaqë interesin e ndërtimit të lidhjes me rrjetin e transmetimit, duhet të paraqesi kërkesën për lidhjen e Marrëveshjes së Lidhjes me OST sh.a., duke patur në konsideratë kushtet dhe kërkesat teknike. Në rast tejkalimi të afateve kohore, atëherë procesi i aplikimit për lidhje rifillon nga e para. Nëse kushtet e rrjetit të transmetimit do të kenë ndryshuar në fazën që ju do të jeni të gatshëm për nënshkrimin e "Marrëveshjes së Lidhjes" dhe fillimin e punimeve, OST ruan të drejtën e

rishikimit të mënyrës së lidhjes, e cila mund të mbetet e njëjtë apo mund të ndryshojë, duke respektuar kërkesat e Kodit të Transmetimit.

Përpara fillimit të punimeve për realizimin e kësaj lidhjeje, nga ana e shoqërisë aplikuese për lidhje me Rrjetin Kombëtar të Transmetimit, do të kryhet pagesa e Tarifave përkatëse sipas “Rregullores së procedurave për lidhjet e reja dhe modifikimin e lidhjeve ekzistuese me rrjetin e transmetimit”, miratuar me Vendim të ERE-s Nr.87, date 20.04.2018.

Pas nënshkrimit të “Marreveshjes së Lidhjes”, investitori fillon punën për realizimin e projektit të zbatimit, ku pjesa që i përket transformimit 110/6,3 kV, linjës 110 kV dhe pikës së lidhjes në rrjetin e transmetimit, duhet të dërgohen në kompaninë OST sh.a. përpara fillimit të implementimit për të marrë aprovimin teknik.

Ju faleminderit për mirëkuptimin,

ADMINISTRATORI i OST sh.a.

